



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 23 Prill 2021

Nr. 277

VENDIM

- Objekt:** Për shqyrtimin administrativ të denoncimeve të Partisë Demokratike për shkelje të parashikuara në udhëzimin nr. 6 datë 23.03.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, ndaj kandidates për deputete zj. Ogerta Manastirliu
- Kallëzues:** Partia Demokratike
- Ndaj:** Kandidates për deputete zj. Ogerta Manastirliu
- Baza Ligjore:** Neni 19, pika 1, shkronja “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, neneve 60, 61, dhe vijues të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, udhëzimit nr. 6, datë 23.03.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga administrata gjatë procesit të hetimit administrativ,

VËREN:

I.Vlerësimi paraprak

Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në portalin e denoncimeve janë raportuar disa denoncime nga subjekti politik Partia Demokratike me nr. ID të gjeneruar nga sistemi 2707, 2712 dhe 3107, ndaj kandidates për deputet zj. Ogerta Manastirliu, në Qarkun e Tiranës. Sipas denoncuesit me pretendimin se, në kundërshtim me udhëzimin nr. 6, datë 23.03.2021 të

Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve në KQZ, ka hapur zyrën e saj elektorale përballë me qendrat e votimit nr. 1951; 1951/1; 1955; 1955/1; 1955/2; 1968; 1968/1

Referuar nenit 23, të ligjit nr. 44/20151 “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë”, “Me fillimin e procedurës administrative, organi publik verifikon nëse ka apo jo kompetencë lëndore dhe tokësore për të vendosur për çështjen objekt shqyrtimi.”

Sipas përcaktimeve të neneve 19, paragrafi 1, shkronja “dh”, “f” dhe “n” e paragrafi 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka kompetencat si më poshtë:

dh) kujdeset për zbatimin e këtij ligji në mënyrë të drejtë, të përpiktë, të saktë dhe uniforme nga të gjitha institucionet, subjektet apo personat e ngarkuar me detyra dhe detyrime, sipas ligjit;

f) monitoron nëpërmjet administratës së KQZ-së apo subjekteve të kontraktuara sjelljen e institucioneve publike gjatë fushatës dhe përdorimin e burimeve publike;

n) ushtron në emër të KQZ-së kompetencat që i ngarkohen asaj me ligje të veçanta, si dhe çdo kompetencë që ky ligj nuk ia njuh shprehimisht Rregullatorit ose KAS-it.

Referuar kompetencave sa më sipër, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vendos shqyrtimin bashkërisht të denoncimeve pasi konstaton se kanë të njëjtin subjekt dhe objekt, në të cilat pretendohet shkelje të parashikuara në nenin 5, pika 1, të udhëzimit nr. 6 datë 23.03.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, për denoncimet si vijon:

1. Denoncim me numër ID të gjeneruar nga sistemi 2707 dt. 01.04.2021
2. Denoncim me numër ID të gjeneruar nga sistemi 2712 dt. 01.04.2021
3. Denoncim me numër ID të gjeneruar nga sistemi 3107 dt. 12.04.2021

Referuar nenit 82 e vijues të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve çmon se të dhënat e paraqitura nga subjekti kallëzues Partia Demokratike, përbëjnë indicie të besueshme për të filluar një procedurë administrative.

II. Rrethanat e faktit

Në datën 23.03.2021 Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, ka miratuar udhëzimin nr. 6 “Për përdorimin e materialeve propagandistike e edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore”.

Lidhur me 3 denoncimet të ardhura në portalin e KQZ-së ndaj kandidates për deputet zj. Ogerta



Manastirliu, administrata e KQZ-së, përmes personit të autorizuar prej saj, ka verifikuar denoncimet e bëra nga Partia Demokratike dhe nga informacioni i sjellë nëpërmjet email-it, administruar nga KQZ me nr. 4270 prot., datë 22.04.2021, rezulton se:

- 1- Gjatë monitorimit të njësisë administrative nr. 9, subjekti Zgjedhor, Partia Socialiste, ka hapur një zyrë elektorale në një distancë më të vogël se 300 metra me QV 1951 dhe QV 1951/1. Sipas informacioneve të mbledhura pranë kësaj zone, zyra rezulton se ka më pak se dy javë që është hapur. Monitoruesi bën me dije se, që nga momenti i evidentimit të kësaj shkeljeje, gjatë kohës së qëndrimit të tij në zonë për të monitoruar, nuk e ka gjetur zyrën për asnjë moment të hapur.
- 2- Gjatë monitorimit të njësisë administrative nr. 9, subjekti zgjedhor, Partia Socialiste, ka hapur një zyrë elektorale në një distancë më të vogël se 300 metra me QV 1955, 1955/1 dhe 1955/2. Sipas informacioneve të mbledhura pranë kësaj zone, zyra ka një javë që është hapur. Që nga momenti i evidentimit të kësaj shkeljeje, gjatë kohës së qëndrimit të monitoruesit në zonë për të monitoruar, nuk e ka gjetur për asnjë moment të hapur.
- 3- Lidhur me zyrën zgjedhore të pretenduar se është hapur pa respektuar distancën 300 metra me QV-të nr. 1968 dhe 1968/1, nga raporti i monitoruesit bëhet e ditur se subjekti politik Partia Socialiste, në datën 21.04.2021, nuk rezulton me asnjë zyrë elektorale të hapur në këtë zonë.

III. Analiza ligjore

Në vlerësim të provave dhe fakteve të sipërpërmendura, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhor çmon se:

Referuar nenit 5, pika 1, të udhëzimit nr. 6 datë 23.03.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, në KQZ Rregullator, parashikohet se:

“Zyrat zgjedhore të subjekteve zgjedhorë mund të hapen në një distancë jo më të vogël se 300 (treqind) metra nga vendndodhja e KZAZ-ve, QV-ve dhe VNV-ve.”

Lidhur me rastet objekt denoncimi, referuar raporteve të monitoruesit të caktuar nga KQZ-ja, zyra zgjedhore e hapur nga subjekti politik Partia Socialiste, afër QV-së nr. 1951 dhe QV-së 1951/1 dhe zyra zgjedhore e hapur afër QV-ve nr. 1955, 1955/1 dhe 1955/2 nuk rezultojnë në përmbushje të kushtit nënligjor të sipërcituar, përcaktuar në udhëzimin nr. 6/2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

Referuar nenit 5, pika 4, të udhëzimit nr. 6 datë 23.03.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, në KQZ Rregullator, parashikohet se:



“Policia bashkiake garanton zbatimin e detyrimit të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni me kërkesë të KQZ-së.”

Për sa më sipër në mbështetje të dokumentacionit të disponuar, provave dhe fakteve të administruara gjatë hetimit administrativ rezultoi e provuar se hapja e dy zyrave elektorale të subjektit politik Partia Socialiste, në Njësinë Administrative nr. 9, është në shkelje të kushtit nëligjor të përcaktuar në nenin 5, pika 1 të udhëzimit nr. 6/, datë 23.03.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronja “dh”, “f”, “n”, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 60 dhe vijues të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, udhëzimit nr. 6, datë 23.03.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve:

V E N D O S:

- 1- Policia bashkiake, të marrë masa të menjëhershme për të mbyllur zyrën zgjedhore të subjektit politik Partia Socialiste afër qendrës së votimit nr. 1951 dhe 1951/1 dhe zyrën zgjedhore afër qendrës së votimit nr. 1955, 1955/1 dhe 1955/2, në qarkun Tiranë.
- 2- Kryetari i Bashkisë Tiranë, të njoftojë menjëherë Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për zbatimin e këtij vendimi.
- 3- Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen me postë elektronike denoncuesit.
- 4- Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga hyrja e tij në fuqi.
- 5- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Ilirjan CELIBASHI

